



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 shkurt 2024
Nr. Ref.: RK 2350/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI134/23

Parashtruese

Feride Berisha

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. Nr. 394/2022, të 12 tetorit 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Feride Berisha (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. Nr. 394/2022] të 12 tetorit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesja e kërkesës, Aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 22 shkurt 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme. Megjithatë, parashtruesja e kërkesës nuk ka specifikuar se cilat të drejta dhe liri të saja të saj, të garantuara me dispozitat Kapitullit II [Të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) i janë shkelur përmes Aktvendimit të kontestuar.

Baza juridike

5. Kërkesat bazohen në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve), të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

7. Më 16 qershor 2023, parashtruesja e kërkesës, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 27 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR.KI dhe Nr. KSH. KI134/23] e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
9. Më 21 korrik 2023, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi asaj që të dorëzojë: (i) formularin e plotësuar dhe të nënshkruar të kërkesës, pasi që i njëjti nuk ishte i plotësuar në tërësi dhe i mungonte nënshkrimi; dhe (ii) kopjet e të gjitha vendimeve të organeve kompetente dhe gjykatave të rregullta, përfshirë edhe parashtruesat dhe ankesat e paraqitura nga ajo. Po të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme në lidhje me regjistrimin e kërkesës dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Divizioni Civil (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) i kërkoi dorëzimin e fletëkthesës e cila dëshmon se kur parashtruesja e kërkesës ka pranuar Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

10. Më 25 korrik 2023, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesën e kërkuar, e cila dëshmon që parashtruesja e kërkesës Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 22 shkurt 2023.
11. Më 11 gusht 2023, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një shtojcë të formularit të kërkesës, të nënshkruar, me adresë të vendbanimit dhe numrin kontaktues, duke i bashkëngjitur edhe kopjet: e vendimeve të “SOS Fshatrave të Fëmijëve të Kosovës”; të Inspektoratit të punës; të vendimeve të gjykatave të rregullta; dhe të ankesave dhe parashtresave të paraqitura nga ajo para autoriteteve publike.
12. Më 17 janar 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesave.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesja e kërkesës, më 1 shkurt 2010 kishte lidhur Marrëveshje për shërbime afatgjata (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja) me SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: SOS Fshatrat) për ofrimin e shërbimeve si SOS nënë në njërin nga SOS familjet e SOS Fshatrave.
14. Më 21 tetor 2016, Zyra Nacionale e SOS Fshatrave e njoftoi parashtruesen e kërkesës për zgjidhjen e Marrëveshjes së lartcekur për shërbime, efektive nga datat 22 tetor 2016. Zgjidhjen e Marrëveshjes së lartcekur, SOS Fshatrat e arsyetuan me faktin se sjellja e vazhdueshme e parashtrueses së kërkesës në trajtimin jo të barabartë dhe cenim të të drejtave të fëmijëve ishte në kundërshtim me politikat dhe filozofinë e SOS Fshatrave, dhe rregullave të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Në fund të Njoftimit të tyre, SOS Fshatrat specifikuan se ndaj saj do të realizohen të gjitha obligimet që dalin nga Marrëveshja, përfshirë kompensimin mujor për tetëmbëdhjetë (18) ditë pune të muajit tetor 2016, kompensimet për ditët e pushimit të viteve 2014, 2015 dhe 2016 dhe pagën e 13-të për vitin 2016. Njoftimi për zgjidhje të marrëveshjes, nuk përmban këshillë juridike.
15. Më 24 tetor 2016, kundër Njoftimit të lartcekur, parashtruesja e kërkesës dorëzoi ankesë për “largim joligjor dhe jonjerëzor nga puna” dhe ankesë kundër “procesverbalit” të 21 tetorit 2016, ku është mbajtur takimi për njoftimin e saj për zgjidhje të Marrëveshjes. Nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesja e kërkesës me të njëjtën ankesë i është drejtuar edhe Avokatit të Popullit, megjithatë e njëjta në lidhje me këtë nuk ka dorëzuar informata nëse kjo ankesë është trajtuar dhe nëse është dorëzuar ndonjë përgjigje ndaj ankesës së saj nga ky institucion.
16. Më 1 nëntor 2016, SOS Fshatrat në përgjigje të ankesës së saj, të shqyrtuar nga Bordi i Drejtorëve të SOS Fshatrave, njoftuan parashtruesen e kërkesës se: (i) raporti i saj me SOS Fshatrat nuk është marrëdhënie pune që qeveriset nga Ligji i Punës por është Marrëveshje për Shërbime, shërbime të përkujdesjes së fëmijëve, si formë përkrahëse, alternative e strehimit familjar të fëmijëve pa përkujdesje, që “organizata SOS Fshatrat e Fëmijëve e ofron në bashkëpunim me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale”: (ii) se i njëjti e ka marrë në shqyrtim ankesën e saj duke kërkuar raporte të detajuara nga zyrtarët profesionistë, si pedadogun, psikologun dhe punëtorin social, të cilët mbikëqyrin përkujdesjen e ofruar nga SOS Nënata ndaj fëmijëve pa përkujdesje prindërore.” ; (iii) nga dosja rezulton që vërejtje ndaj sjelljes së saj janë adresuar në vazhdimësi për trajtim jo të barabartë të fëmijëve që i janë besuar në përkujdesje; cenim të të “drejtave bazike të fëmijëve për dashuri dhe mbrojtje nga diskriminimi” dhe “fyerje dhe lëndim shpirtëror të disa fëmijëve në përkujdesje të saj”; (iv) se veprimet e saja kanë rezultuar në shkelje të Kodit të Mirësjelljes të Organizatës, Politikën për Mbrojtje të

Fëmijëve dhe Vlerat, vizionin dhe filozofinë e Organizatës SOS Fshatrat e Fëmijëve; (v) se zgjidhja e Marrëveshjes është bërë duke marrë për bazë interesin më të mirë të fëmijëve dhe mirëqenien e tyre; (vi) se raportet specialistike do t'i dorëzohen Organit të Kujdestarisë të Qendrës për Punë Sociale dhe kujdestarit ligjor të fëmijëve dhe në bashkëpunim me ta do të vendoset për hapat dhe procedimet e mëtejme ndaj saj. Nga përmbajtja e përgjigjes, rezulton që parashtrueses së kërkesës, bashkë me përgjigjen i janë bashkëngjitur “raportet psiko-pedagogjike” të SOS Fshatrave. Përgjigja e Bordit të Drejtorëve, nuk përmban këshillë juridike.

17. Më 4 nëntor 2016, parashtruesja e kërkesës në Inspektoratin e Punës dorëzoi ankesë për “largim jo njerëzor dhe joligjor nga puna”.
18. Më 18 nëntor 2016, Inspektorati i Punës përmes Vendimit [nr. 37-00215/16-A] hudhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës për shkak të mungesës së kompetencës së Inspektoratit në këtë çështje. Inspektorati i Punës arsyetoi se specifikat e Marrëveshjes për ofrimin e shërbimeve të lidhura me SOS Fshatrat e Fëmijëve nuk janë elemente që rregullohen me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-212 të Punës (në tekstin e mëtejme: Ligji i Punës). Në këshillin juridike, të këtij vendimi specifikohet se mund të paraqitet ankesë në Trupin Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës.
19. Në një datë të paspecifikuar, kundër Vendimit të Inspektoratit të Punës, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Trupin Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës.
20. Më 19 janar 2017, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës përmes Vendimit [03/2017] ankesën e parashtrueses së kërkesës e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Vendimin e 18 nëntorit 2016, të Inspektoratit të Punës. Në këshillën juridike, të këtij vendimi specifikohet se mund të iniciohet kontest administrativ në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh.
21. Më 31 janar 2017, parashtruesja e kërkesës në Gjykatën Themelore dorëzoi kërkesëpadi për kthim në vendin e saj të punës dhe kompensim për dëm material.
22. Më 12 dhjetor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. Nr. 217/17] hudhi si të palejueshme kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës duke konstatuar se e njëjta ishte e pasafatshme. Gjykata Themelore konstatoi se kërkesëpadija e parashtrueses së kërkesës nuk ishte dorëzuar brenda afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar me nenin 79 të Ligjit të Punës, i cili afat ka filluar të rrjedhë që nga dita e pranimit të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të SOS Fshatrave, të 1 nëntorit 2016.
23. Më 12 qershor 2020, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit.
24. Më 6 qershor 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. Nr. 4850/20] ankesën e parashtrueses së kërkesës e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin [C. Nr. 217/17] të 12 dhjetorit 2019 të Gjykatës Themelore.
25. Më 6 shtator 2022, parashtruesja e kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme.
26. Më 12 tetor 2022, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. Nr. 394/2022] revizionin e parashtrueses së kërkesës e refuzoi si të pathemeltë. Gjykata Supreme vërtetoi qëndrimet dhe konstatimet e gjykatave të shkallës më të ulët, duke konstatuar se padija e parashtrueses së kërkesës është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 79 të Ligjit të Punës.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

27. Parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj nuk ka specifikuar se cilat dispozita të Kapitullit II të Kushtetutës, që garantojnë të drejtat dhe lirit themelore të saja i janë shkelur përmes Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
28. Në kërkesën e saj, parashtruesja e kërkesës ka ngritur pretendime të shumta, në mënyrë specifike ndaj vendimmarrjes së SOS Fshatrave për zgjidhjen e marrëveshjes për shërbime afatgjata me SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës. Përveç kësaj, ajo kërkon kthimin e saj “në vendin e mëparshëm të punës” dhe po ashtu i kërkon Gjykatës që të “kërkojë qasje në të gjithë dokumentacionin zyrtar” në mënyrë që e njëjta të vërtetojë “se a përputhen dokumentacioni me realitetin”. Përgjatë gjithë kërkesës së saj, përmes deklaratave tejet të detajuara, ajo në thelb konsideron se zgjidhja e marrëveshjes ishte e padrejtë për arsye se ajo kishte arritur suksese gjatë përkujdesjes së fëmijëve duke e ngritur edhe mirëqenien e tyre arsimore.
29. Në lidhje me konstatimin e vendimeve të gjykatave të rregullta, përmes të cilave kërkesëpadia e saj ishte hudhur si e pasafatshme, parashtruesja e kërkesës pohon se ajo e ka ndjekur këshillën juridike të Inspektoratit të Punës përmes Vendimit të tij për të parashtruar ankesë në shkallën e dytë të Inspektoratit.

Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.”

Rregullorja e punës

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 të të njëjtit nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

31. Gjykata më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen në Ligj. Në lidhje me këtë, sipas paragrafit 1 të nenit 48 (Saktësimi i kërkesës), specifikohet se parashtruesi/ja e kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin ai/ajo e konteston para Gjykatës.
32. Andaj, Gjykata vëren se neni 48 i Ligjit përmban gjithsej dy kërkesa. E para konsiston në (i) obligimin e parashtruesve të kërkesës dhe detyrimin e tyre që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar nga autoriteti publik – vendimin e të cilit e kontestojnë; dhe, e dyta konsiston në (ii) obligimin e parashtruesve të kërkesës dhe detyrimin e tyre që të specifikojnë aktin konkret të autoritetit publik që dëshirojnë ta kontestojnë para Gjykatës Kushtetuese. Që të dy këto kriterë të nenit 48 të Ligjit e veçanërisht kriteri i parë i këtij neni reflektohet edhe në rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës ku kërkohet që një kërkesë e parashtruar në Gjykatë duhet të qartësojë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI73/21, parashtrues *Minire Krasniqi-Zhitia*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2021, paragrafi 39; dhe KI91/17, parashtrues *Enver Islami*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 31).
33. Lidhur me rastin konkret, sa i përket këtyre kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara me Ligj dhe më tej të specifikuara në Rregullore të punës, Gjykata thekson se përkundër faktit që parashtruesja e kërkesës ka specifikuar qartë se e konteston Aktvendimin [Rev. Nr. 394/2022] të 12 tetorit 2022, të Gjykatës Supreme, ajo nuk e ka përmbushur detyrimin e saj që të *“qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar”* nga autoriteti publik, përkatësisht Gjykata Supreme në rastin konkret.
34. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me vendimet e gjykatave të rregullta, marre parasysh faktin që e njëjta përmes kërkesëpadisë kishte kërkuar kthimin *“në vendin e saj të mëparshëm të punës”* dhe kompensimin përkatës për dëm material. Megjithatë, parashtruesja nuk ka qartësuar se cilat të drejta dhe liri, të garantuara me Kushtetutë, pretendon se i janë cenuar. Përkatësisht, kërkesa e saj me sqarime të hollësishme i referohet pakënaqësisë së saj për zgjidhje të marrëveshjes, përmes të cilës ajo kishte ofruar shërbime si SOS nënë në njërin nga SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe për të cilën zgjidhje pretendon se ishte e padrejtë. Bazuar në sqarimet e saja, parashtruesja e kërkesës në thelb kërkon nga Gjykata që kjo e fundit të kërkojë qasje në të gjithë dokumentacionin e SOS Fshatrave dhe të shqyrtojë dhe verifikojë faktet në lidhje me sjelljen e saj si SOS nënë në SOS Fshatrat.
35. Në lidhje me të lartcekurat, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kishte paraqitura ankesa të shumta si para SOS Fshatrave dhe autoriteteve tjera publike, përfshirë edhe Inspektoratin e Punës, dhe në vijim kishte parashtruar edhe kërkesëpadi në Gjykatën Themelore. Megjithatë, si rezultat i konstatimit të kësaj të fundit se kërkesëpadija e saj ishte e pasafatshme, gjykatat e rregullta nuk e kishin shqyrtuar dhe vlerësuar në merita pretendimet e saj në kërkesëpadi. Prandaj, Gjykata po ashtu vlerëson se pretendimet dhe sqarimet e parashtrueses së kërkesës në kërkesën e saj i referohen çështjeve të vlerësimit të fakteve, të cilat gjykatat e rregullta nuk i kishin shqyrtuar dhe dhënë qëndrim juridik, si rezultat i hudhjes poshtë të kërkesëpadisë si të pasafatshme.
36. Për më tepër, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës ka pohuar se ajo ka vepruar në bazë të këshillës juridike të dhënë në Vendimin e Inspektoratit të punës, të 18 nëntorit 2016, mirëpo në këtë kontekst specifik nuk ka saktësuar se cila e drejtë e saj kushtetuese është cenuar nga ana e gjykatave të rregullta.

37. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës përmes kërkesës së saj nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar nga autoriteti publik, dhe si e tillë kërkesa duhet të refuzohet për mosplotësimin e kriterëve të pranueshmërisë të parapara me nenin 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës.
38. Si rrjedhojë, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës, më 17 janar 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË, këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË, këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani



Gresa Caka-Nimani